

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6993
E martë, 12 shtator 2023
Çmimi 0.40

Kurti: Synimi ynë është t'i çmontojmë strukturat që mundësojnë pabarazi



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FREDERIC ABRAHAMS NGA HUMAN RIGHTS WATCH (HRW) KA PËRFUNDUAR DËSHMINË NË RASTIN E HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

PËRFUNDON DËSHMINË ZYRTARI I HRW-SË QË U DEMOLUA NGA MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-së

Pas marrjes në pyetje disa ditë me radhë nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së, ka përfunduar dëshminë në Gjykatën Speciale zyrtari i Human Rights Watch (HRW), Federick Abrahams. Përgjatë këtyre ditëve ai është ballafaquar nga avokatët e liderëve të UÇK-së, të cilët i kanë demoluar raportet e përpiluara nga HRW-ja për UÇK-në. Madje, në një rast, Abrahamsi është detyruar të pranonte se ka gabuar në raportin e tij kur ka bërë disa konstatime për UÇK-në. Ndërsa të hënën mbrojtja e katërshes së UÇK-së ka ofruar fakte se si një nga gazetarët serbë, i arrestuar dhe më pas i liruar nga UÇK-ja, ishte i përfshirë edhe në krime lufte në Kroaci



LIDERËT E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR U MBLODHËN TË HËNËN NË SAMITIN E BËRDO-BRIONIT NË SHKUP

OSMANI: ËSHTË INTERES TRATEGJIK QË KOSOVËS T'I JEPET STATUSI I VENDIT KANDIDAT NGA BE-ja



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE
BIE NUMRI I PERSONAVE QË KANË MARRË PAGË PA QENË NË MARRËDHËNIE PUNE, 51 RASTE DËRGOHEN NË PROKURORI

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mok: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...


OPINION

ÇFARË BËJNË TË GJITHË ATA KËSHILLTARË QEVERITARË? F.7

Milazim KRASNIQI



AKTUALE



KONJUFCA PRET NË TAKIM DEPUTETIN GJERMAN, E FALËNDERON PËR ANGAZHIMIN PËR KOSOVËN F.5

NJËZET E DY VJET NGA SULMET QË TRONDITËN BOTËN F.2

EMIN HOXHAJ EMËROHET DREJTOR I AGJENCISË PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR F.7

EKONOMI



KOSOVA DHE IZRAELI NËNSHKRUAJNË DEKLARATËN E PËRBASHKËT PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E TURIZMIT F.8

RITJA EKONOMIKE NË BE, MË E NGADALSHME SESA QË PRITEJ F.8

Njëzet e dy vjet nga sulmet që tronditën botën

Uashington, 11 shtator - Mëngjesin e 11 shtatorit 2001 banorët e Nju-Jorkut po bëheshin gati ta nisnin ditën, kur një avion i rrëmbyer goditi qëllimisht njërën kullë të Qendrës Botërore të Tregtisë. Ishte ora 08:46. Vetëm 17 minuta më vonë, një avion tjetër, po ashtu i rrëmbyer, u përplas për kullën e dytë. Dy ndërtesat 110-katëshe - rrokaqiejt më të lartë në Nju-Jork - i përfshinë flakët, ndërsa qindra punonjës të shërbimit të

urgjencës nxituan drejt kullave për t'i ndihmuar të ngujuarit brenda. Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 2001, George W. Bush, ishte duke vizituar një shkollë në Florida kur ndodhën sulmet. Duke folur prej atje, ai tha se ngjarja në Nju-Jork duket se është "një sulm terrorist kundër vendit tonë". Vetëm pak minuta pas deklaratës së tij, në orën 09:37, avioni i tretë i rrëmbyer u përplas qëllimisht për njërën

anë të ndërtesës së Pentagonit - selisë së mbrojtjes amerikane - pranë Uashingtonit. Avioni i katërt, që besohet se kishte në shënjestër ndërtesën e Kongresit, gjithashtu në Uashington, u rrëzua në një fushë në Pensilvani, pasi pasagjerët luftuan kundër rrëmbyesve. Në total, 2 977 njerëz - pa përfshirë 19 rrëmbyesit e avionëve - vdiqën në sulme, ndërsa mijëra të tjerë u plagosën.



ShBA-ja dhe Armenia nisin stërvitjet e përbashkëta ushtarake

WASHINGTON, 11 SHTATOR - Armenia dhe Shtetet e Bashkuara kanë nisur stërvitjet e përbashkëta ushtarake që kanë zemëruar Moskën. Stërvitjet po mbahen në kohën e rritjes së tensioneve midis Jerevanit dhe Azerbajxhanit fqinj lidhur me rajonin e shkëputur të Nagorno-Karabakut. Ministria e Mbrojtjes e Armenisë tha se stërvitjet e quajtura "Eagle Partner 2023" nisen më 11 shtator me qëllim të përgatitjes së forcave armene për pjesëmarrje në misione paqeruajtëse ndërkombëtare. Kolonel Martin O'Donnell, zëdhënës i komandës amerikane, tha se stërvitjet "janë një mundësi vitale për ushtarët nga të dyja shtetet që të ndërtojnë një raport

të ri në nivelin taktik dhe të rritin ndërveprimin për operacionet paqeruajtëse". Stërvitjet po mbahen në Zar dhe në Armavir afër Jerevanit dhe do të përfundojnë më 20 shtator. Ushtria amerikane tha se 85 ushtarë të saj dhe 175 armenë po marrin pjesë në stërvitje. Ushtria e ShBA-së tha se në stërvitje janë përfshirë edhe armët e rënda. Rusia, që udhëheq Organizatën e Traktatit për Siguri Kolektive (CSTO), ku bën pjesë edhe Armenia, ka shprehur shqetësime lidhur me stërvitjet e përbashkëta që po mbahen në kohën kur raportet në mes të Moskës dhe Jerevanit kanë shfaqur shenja të dobësimit. Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, më 10 shtator shprehu



keqardhje lidhur me "veprimet e udhëheqjes armene" duke thënë se nuk pret "asgjë të mirë" nga stërvitjet e përbashkëta, ndërkaq zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se Rusia "do ta

monitorojë situatën". Më 8 shtator Ministria e Jashtëm ruse ftoi në takim ambasadorin armen për të protestuar për "hapat jomiqësorë" të ndërmarra nga Jerevani, përfshirë edhe

stërvitjet ushtarake. Në Jerevan, ndërkaq, kryeministri Nikol Pashinian akuzoi Rusinë se ka dështuar ta mbrojë Armeninë lidhur me atë që ai e cilësoi si agresion të vazhdueshëm nga Azerbajxhani. Rusia ka forca paqeruajtëse në rajon, që mbikëqyrin zbatimin e marrëveshjes që i dha fund luftës që Armenia dhe Azerbajxhani zhvilluan më 2020 - lufta e dytë që këto dy shtete kanë zhvilluar që nga rënia e Bashkimit Sovjetik. Por, Jerevani i ka akuzuar forcat paqeruajtëse ruse se po dështojnë t'i mbrojnë armenët në Nagorno-Karabak, një enklavë që ndërkombëtarisht njihet si pjesë e Azerbajxhanit, por që është e banuar nga afër 120 000 armenë etnikë.

Ekipet e huaja i bashkohen Marokut në përpjekjet për kërkim-shpëtim



PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ekipet e kërkim-shpëtimit po luftojnë me kohën teksa gërmojnë për të gjetur ndonjë të mbijetuar nën rrënoja në Marok, pas tërmetit më të fuqishëm që është regjistruar ndonjëherë në këtë shtet. Një tërmet 6.8 shkallësh i Rihterit e ka goditur të premten qytetin jugperëndimor Marrakesh dhe, për pasojë, kanë vdekur 2 497 persona, ndërsa mbi 2 400 të tjerë janë lënduar. Autoritetet marokene kanë

thënë se ekipet nga Spanja, Britania, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë shkuar në Marok për t'u ndihmuar autoriteteve vendore. Edhe Forca e Sigurisë së Kosovës ka shprehur gatishmërinë t'i ofrojë ndihmë Marokut. Sipas Ministrisë së Brendshme marokene, në të ardhmen mund të pranohen edhe ofertat e vendeve të tjera, pasi dërgimi i më shumë ekipeve në këtë pikë në Marok mund të jetë kundërproduktiv për shkak të

mungesës së koordinimit. Tërmeti e ka bërë rrafsh me tokë fshatin Tafegagte në provincën Al-Haouz, rreth 60 kilometra larg Marrakeshit. Sipas agjencisë së lajmeve AFP, pak ndërtesa shihen në këmbë. "Gjithçka është shkatërruar. Më është thyer zemra", është cituar të ketë thënë Zahra Benbrik, 62 vjeçe, së cilës i kanë vdekur 18 familjarë si pasojë e tërmetit. Sipas medieve në Marok, më shumë se 18 000 familje janë prekur nga ky tërmet.

Rajonet e prekura nga vërshimet në Greqi, ende pa rrymë

ATHINË, 11 SHTATOR - Si pasojë e mungesës së rrymës, rajonet e prekura nga vërshimet në Greqi kanë mbetur edhe pa ujë të pijshëm. Në qytetin Volos me 150 000 banorë, rrjeti i furnizimit me ujë është shumë i dëmtuar, prandaj

banorët e zonës janë duke siguruar furnizime nëpër rrugë alternative, ka raportuar të hënën faqja e lajmeve ERT. Sipas brigadës së zjarrit, pothuajse 4 500 persona janë shpëtuar deri më tani, mirëpo puna e ekipeve të shpëtimit

është duke vazhduar. Ka ende njerëz të zhdukur dhe numri i të vdekurve nga vërshimet ka shkuar në 15 të hënën, ka thënë kjo brigadë. Shkalla e saktë e dëmeve nuk dihet ende, pasi në shumë zona shihen vetëm kulmet e shtëpive.

Javën e kaluar Greqia është përballur me stuhi të fuqishme. Shirat e rrëmbyeshëm kanë përmbytur fshatra dhe qyteza. Sasia e shiut ka arritur në nivele të pashembullta, më shumë se 700 milimetra në më pak se 24 orë.



LIDERËT E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR U MBLODHËN TË HËNËN NË SAMITIN E BËRDO-BRIONIT NË SHKUP

Osmani: Është interes strategjik që Kosovës t'i jepet statusi i vendit kandidat nga BE-ja

Në samitin e Procesit të Bërdo-Brionit, të mbajtur në Shkup më 11 shtator, Kosovës dhe Serbisë iu bë thirrje të mos ndërpresin komunikimin, përderisa takimi në Maqedoninë e Veriut u fokusua në integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Ndërkaq presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se është interes strategjik që Kosovës t'i jepet statusi i vendit kandidat nga Bashkimi Evropian

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

SHKUP, 11 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në takimin vjetor të krerëve të shteteve të rajonit në kuadër të Procesit të Bërdo-Brionit, në sesionin e përbashkët ka mbajtur një fjalim, në të cilin ka theksuar se Kosova është e vendosur t'i vazhdojë reformat dinamike që forcojnë më tej demokracinë, mbështetin sundimin e ligjit dhe rritin standardet e jetesës për të gjithë qytetarët.

Përderisa aplikimi ynë për anëtarësim në Këshillin e Evropës po shqyrtohet nga Asambleja Parlamentare, është me rëndësi që Kosova të ecë përpara edhe me statusin e kandidatit në BE, në përputhje me zotimin e BE-së për perspektivë anëtarësimi për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Që nga takimi i fundit i këtij procesi presidentja Osmani ka theksuar se Kosova ka shënuar hapa të ndjeshëm suksesi në disa aspekte. "Kosova është një partner i besueshëm, një fqinj i mirë dhe një partner që punon shumë. Prandaj, mundësia për një lëvizshmëri më të madhe të qytetarëve tanë në zonën Schengen është, gjithashtu, një mundësi e madhe për t'ua

vërtetuar këtë të gjithëve në BE", ka theksuar presidentja Osmani. Në këtë kontekst, ka përmendur edhe përparimin në indeksat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me luftimin e krimit dhe korrupsionit, të drejtat e njeriut, fushën e teknologjisë informative etj. Në një pjesë të fjalimit të saj, duke qenë edhe tema të takimit të sivjetmë të liderëve, Osmani foli edhe për efektet e ndryshimeve klimatike dhe tha se Kosova është përcaktuar për të ardhmen e gjelbër të saj. Presidentja tha se tranzicioni i gjelbër është mundësi e mirë për gjenerim të vendeve të punës, rritje të produktivitetit dhe sigurim të energjisë.

Ndërkaq në raport me perspektivën e të rinjve të Kosovës, presidentja Osmani tha se më shumë se gjysma e popullsisë së Kosovës është nën 30 vjeç ndaj, sipas saj, ndërtimi i një mjedisi ku mundësitë për zhvillim social dhe ekonomik janë lehtësisht të disponueshme, janë prioritet në mënyrë që ata ta ndërtojnë të ardhmen e tyre në Kosovë.

Kosova dhe Serbia "të mos ndërpresin komunikimin"

Në një konferencë për medie, presidenti i Kroacisë, Zoran Millanović, u pyet nëse është



më e rëndësishme zgjidhja e çështjeve të hapura për shtetet që synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian apo plotësimi i kriterëve për anëtarësim. Ai tha se të dyja janë të rëndësishme. "Ekzistojnë çështje të hapura, veçanërisht në mes të Serbisë dhe Kosovës, të cilat nuk e njohin njëra-tjetrën. Këto janë dy procese që zhvillohen paralelisht, në të njëjtën kohë dua të rithekoj se mendoj që bisedimet kanë vlerë dhe më e keqja ndodh kur ndërpriten linjat telefonike, ajo është vdekje, vdekje për dialogun, për komunikimin, për mirëkuptimin e ndërsjellë, por edhe për keqkuptimin. Një nga momentet më të rëndësishme në kohën e fundit ka të bëjë me identitetin dhe vetë respektin e vendeve të këtij rajoni. Kjo është kur Ukraina mori statusin e kandidatit para Bosnjë-Hercegovinës. Kjo ishte e

pashpjegueshme, por ja që ndodhi", ka thënë Millanović. "Çështjet bilaterale që i kemi me Serbinë diskutohen në forume të tjera", ka pohuar Osmani kur u pyet nëse është diskutuar për raportet Prishtinë - Beograd. Ajo sërish e fajësoi Serbinë se ka nxitur tensionet në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe, teksa shtoi se masat që ka vendosur BE-ja ndaj Kosovës për shkak të mospërbushjes së kërkesave për shtensionim duhet të hiqen. Kroacia, sipas saj, është një prej shteteve anëtare të bllokut që duhet të jetë ndër të parat që kërkoi diçka të tillë. Ndërkaq, presidenti i Serbisë, Vuçiq, e cilësoi takimin në Shkup si "korrekt dhe të mirë" dhe theksoi se aty nuk u fol për raportin e shtetit të tij me Kosovën. "Prishtina dhe ne i lamë problemet tona për të enjten [takimi i radhës i dialogut Kosovë - Serbi që do të mbahet në Bruksel], kështu që sot u fol më shumë për raportet e rajonit të Ballkanit Perëndimor ndaj BE-së sesa për çdo gjë tjetër", ka theksuar Vuçiqi, duke shtuar se në takimin e liderëve u diskutua për mundësitë ekonomike dhe për tejkalimin e problemeve në të ardhmen. Në anën tjetër, presidenti maqedonas Pendarovski, gjatë konferencës për medie me Millanovićin dhe presidenten slovene Pirc Musar, tha se në raport me aspiratat e Maqedonisë së Veriut drejt BE-së, ekziston një disbalancë e madhe ndërmjet kriterëve tradicionale për hyrje në bllok dhe marrëdhëniet bilaterale me së paku dy fqinjët e Shkupit. "Shpresojmë se kjo do të ndryshojë së shpejti, sepse nëse në Ballkanin Perëndimor insistoni që mosmarrëveshjet thjesht bilaterale të zgjidhen,

veçanërisht nëse ato bazohen në histori dhe emocione, atëherë asnjë vend nga Ballkani Perëndimor nuk do të hyjë kurrë në Bashkimin Evropian", u përgjigj ai në pyetjen se a është më e rëndësishme zgjidhja e çështjeve politike mes shteteve që synojnë anëtarësimin në bllok apo plotësimi i kriterëve që kërkohen nga Brukseli.

Presidentja e Sllovenisë, Pirc Musar, theksoi se e ardhmja e të rinjve mbetet në fokus të zhvillimeve të vendeve të rajonit. Ajo shtoi se pas samitit të Bërdo-Brionit do të inicohej hapa konkretë, sikurse përfshirja e vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj katastrofave natyrore. "Kemi identifikuar që shtetet e Ballkanit Perëndimor të përfshihen në roamingun e Evropës, si dhe anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në mekanizmin e Bashkimit Evropian për përgjigje ndaj katastrofave natyrore", ka thënë ajo.

Në takimin e Procesit të Bërdo-Brionit morën pjesë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani; presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj; presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq; presidentja e Sllovenisë, Natasha Pirc Musar; presidenti i Kroacisë, Zoran Millanović; anëtarët e presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Zelko Komshiq, Denis Beqiroviq dhe Zhelka Cvijanović, dhe presidenti i Malit të Zi, Jakov Millatović. Procesi i Bërdo-Brionit është një nisje slllovene-kroate e ndërmarrë në vitin 2010 nga Borut Pahor, atëbotë kryeministër i Sllovenisë. Qëllim i saj është forcimi i besimit të ndërsjellë në Ballkanin Perëndimor, bashkëpunimi rajonal dhe integrimi më i shpejtë i këtij rajoni në BE.





FREDERIC ABRAHAMS NGA HUMAN RIGHTS WATCH (HRW) KA PËRFUNDUAR DËSHMINË NË RASTIN E HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

Përfundon dëshminë zyrtari i HRW-së që u demolua nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së

Pas marrjes në pyetje disa ditë me radhë nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së, ka përfunduar dëshminë në Gjykatën Speciale zyrtari i Human Rights Watch (HRW), Federick Abrahams. Përgjatë këtyre ditëve ai është ballafaquar nga avokatët e liderëve të UÇK-së, të cilët i kanë demoluar raportet e përpiluara nga HRW-ja për UÇK-në. Madje, në një rast, Abrahamsi është detyruar të pranonte se ka gabuar në raportin e tij kur ka bërë disa konstatime për UÇK-në. Ndërsa të hënën mbrojtja e katërshes së UÇK-së ka ofruar fakte se si një nga gazetarët serbë, i arrestuar dhe më pas i liruar nga UÇK-ja, ishte i përfshirë edhe në krime lufte në Kroaci

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

HAGË, 11 SHTATOR - Zyrtari i organizatës Human Rights Watch (HRW), Federick Abrahams, ka përfunduar dëshminë e tij në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ai në ditën e fundit të dëshmisë së tij, të hënën, u është përgjigjur pyetjeve vijuese të mbrojtjes së Thaçit dhe Veselit mbi bazën e pyetjeve të trupit gjykues.

Dëshmitarin e kanë marrë në pyetje mbrojtësi i Thaçit, avokati Gregory Kehoe dhe mbrojtësi i Veselit, avokati Ben Emmerson.

Lidhur me ndalimin e dy gazetarëve serbë nga UÇK-ja, avokati Kehoe e ka pyetur dëshmitarin nëse e dinte se njëri nga ta ka qenë i përfshirë në krime lufte në Kroaci. "Hetuesit e Tribunalit të Hagës dolën në pretendimin se gazetari ka qenë i përfshirë në kryerjen e krimeve të luftës në Kroaci si pjesëtar i shtypit. Nëse HRW e ka ditur këtë informacion, ju duhet të kishit pasur dyshime nëse Dobriqiq ka qenë gazetar kur është ndaluar?", ka pyetur Kehoe, i cili ka marrë këtë përgjigje nga Abrahamsi. "Duhet parë në dy forma. Është dijenia nëse ne do t'i merrnim parasysh në analizën tonë krimet e

pretenduarat të tij, dhe kritika që kemi bërë në këtu ishte fokusuar në faktin se a ka pasur proces të rregullt ligjor. Nëse do të kishte prova që ka kryer vepra penale në Kosovë apo gjetkë, kjo do të duhej të kishte dalë në gjykim", është përgjigjur dëshmitari Abrahams. Ndërsa Abrahamsi ka thënë se kritika e tyre për këtë çështje ishte e fokusuar nëse ka pasur proces të rregullt ligjor apo jo.

Po ashtu, lidhur me takimin me Hashim Thaçin dhe Fatmir Limajn, Abrahams edhe njëherë ka konfirmuar se Thaçi ishte paraqitur si shef i Drejtorisë Politike dhe se, sipas tij, dukej se ishte përgjegjës më shumë nga ana politike se ushtarake.

Më tutje, dëshmitarit i është paraqitur një artikull ku thuhej se gjykimi ndaj gazetarëve serbë është kryer më 30 shtator 1998, kurse në bazë edhe të njoftimit të HRW-së, këta persona janë deklaruar se kanë humbur më 18 tetor.

Për këtë, avokati Kehoe ka thënë se këtu flitet për një gjykatë ushtarake derisa Thaçi kishte folur se po përpiqeshin t'i krijonin strukturat civile dhe se Abrahamsi ka thënë se padyshim Thaçi ka folur për vështirësitë për krijimin e mekanizmave të duhur. Dëshmitari është pajtuar se Thaçi po përpiquej të bënte të pamundur për ta përfaqësuar sa më mirë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) para komunitetit ndërkombëtar.

Po ashtu, Abrahamsi ka thënë se nuk ka njohuri nëse letrën e 2 dhjetorit 1998, të dërguar pas takimit, ta ketë marrë Thaçi. Kurse për takimin e gushtit 1999, ai ka thënë se, ndonëse takimi me Thaçin ishte bërë në gjuhën shqipe, beson se ai e ka kuptuar thelbin dhe mesazhet e përgjigjeve të bashkëfolësit.

Ndërsa lidhur me rolin e Adem Demaçit, avokati Kehoe ka lexuar një përmbledhje të Prokurorisë për dëshminë e

dëshmitarit Rrustem Mustafa - komandant "Remi" lidhur me ndalimin e një polici serb, i cili ishte liruar pasi Demaçi kishte ndërhyrë dhe se fjala e tij kishte shumë peshë në atë kohë. Me këtë rast, dëshmitari ka thënë se kjo është në përputhje me atë që ka thënë ai sepse, sipas tij, Demaçi kishte autoritet moral dhe respektohej fjala e tij, por se Mustafa ka marrë parasysh kërkesën e tij dhe vetë ka vendosur ta lirojë.

Kështu, duke qenë se Demaçi kishte thënë në një konferencë se nuk mund të vendosë për çështjen e lirim të të ndaluarve dhe Thaçi kishte thënë se nuk është e përshtatshme të ndërhynte në autoritete gjyqësore për këtë çështje, avokati Kehoe ka tërhequr një paralele krahasimi, por se Abrahamsi ka thënë se "sa i takon Demaçit nuk kishte kompetencë të ndërhynte". Kurse për Thaçin, Abrahams ka thënë se ai kishte dhënë arsye se s'mund të ndërhynte për ta cenuar pavarësinë e autoriteteve gjyqësore dhe se lirimi i parakohshëm do të ndikonte në reputacionin e UÇK-së. Por, në vazhdim të kësaj, lidhur me rolin e Demaçit, avokati Kehoe ka lexuar një

Çfarë bëjnë të gjithë ata këshilltarë qeveritarë?



Milazim KRASNIQI

Qeveritarët tanë lënë përshtypjen se nuk kanë haber mbi taktikat që ka përdorur Serbia kundër Kosovës para pushtimit të saj në vitin 1912 e të cilat po i përdorë me sukses edhe sot. Prandaj edhe bien në kurthet serbe, siç ka rënë

sidomos qeveria Kurti. E vërteta është se ka një përsëritshmëri të këtyre taktikave serbe, që nga fillimi i shekullit XX e deri sot, natyrisht me rënie e ngritje. Shikojini taktikat që ka përdorur Serbia në fillim të shekullit XX dhe të cilat saktësisht i përdorë edhe sot! (Çka tregon kjo përsëritshmëri? Kjo tregon se Serbia nuk ka hequr dorë nga strategjia për ripushtimin e Kosovës.)

1. Financimi i serbëve brenda Kosovës.
2. Krijimi i bandave, grupeve të armatosura.

3. Forcimi i ushtrisë në kufi. Bashkëpunimi i fshehtë me grupet e armatosura.

4. Provokimet ndaj shqiptarëve në mënyrë që reagimet e tyre të paraqiten në botë si zullum i shqiptarëve ndaj civilëve të pafajshëm serbë.

5. Përhapja e thashethemeve në funksion të destabilizimit të gjendjes.

6. Kremtimi i Vidovdanit (që nga viti 1904) me mesazhe për shenjtërinë e tokës së Kosovës.

7. Propagimi se Serbia do ta ruante paqen në Ballkan. (Ndërsa përgatitej për luftë.)

8. Mbajtja e Kosovës në tension të vazhdueshëm.

Nga sa u prezantua si faktografi e thatë, (burimin akademik nuk po e tregoj qëllimisht) më mbetet e paqartë se çka bëjnë ata 38 këshilltarë të Albin Kurtit dhe qindra këshilltarë të tjerë në qeveri, kur nuk arrijnë as t'i detektojnë taktikat serbe. Aq më pak e kuptoj çka bëjnë ata këshilltarët e Besnik Bislimit, demok ekspertë të mëdhenj, ndërsa Besnik Bislimi tashmë është bërë simbol i fundosjes politike në dialogun me Serbinë. Bile arsyeja e këtij teksti është t'u tërheqë vëmendjen në këto taktika, para takimit të 14 shtatorit, thjesht për shkak të interesit

tonë shtetëror, i cili nga injoranca e qeveritarëve tanë tashmë është rrezikuar seriozisht. Pra që të kthellohen, të koncentrohen e t'i denoncojnë si taktika dhe synime imperiale serbomëdha. Këto shkojnë përtej kornizës së dialogut. Inskenimet në terren janë vetëm pretekste për të zbatuar strategjinë e ripushtimit të Kosovës, si në kohën e qeverisjes së mbrapshtë xhonturke. (11 shtator 2023)

Konjufca pret në takim deputetin gjerman, e falënderon për angazhimin për Kosovën

Prishtinë, 11 shtator - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim deputetin Michael Roth, njëherësh kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme në Bundestagun gjerman. Gjatë takimit u bisedua për zhvillimet politike në vend dhe rajon, për proceset integruese, për mundësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave parlamentare, si dhe për çështje të tjera me interes të përbashkët. Konjufca i shprehu mirënjohje deputetit Roth për angazhimin dhe qëndrimet e tij parimore karshi zhvillimeve aktuale në rajonin tonë, edhe për mbështetjen që Gjermania i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Kosovës në të gjitha fazat e shtetndërtimit e të integrimit në institucionet euroatlantike dhe organizata e mekanizma ndërkombëtarë. Duke i vlerësuar të shkëlqyera marrëdhëniet dypalëshe, kryetari i Kuvendit theksoi se Gjermania mike është aleate strategjike dhe partnere e rëndësishme e Republikës së Kosovës. Njëkohësisht ai



shprehu gatishmërinë për forcimin e mëtejme të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe e vlerësoi shumë të rëndësishme

përkrahjen e Gjermanisë kundrejt proceseve të cilat i ka përpara shteti ynë.

Ndërsa deputeti dhe kryetari i

Komisionit për Punë të Jashtme në Bundestagun gjerman, Michael Roth, e falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen,

duke rikonfirmuar mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë për Republikën e Kosovës.

pjesë nga marrëveshja për unifikim të UÇK-së dhe FARK-ut, ku thuhet se kjo marrëveshje do të hynte në fuqi në takim pasues ku do të ishte i pranishëm Adem Demaçi. Më tutje, dëshmitari Abrahams ka thënë se Thaçi kishte dalë me deklarata publike duke dënuar dhunën dhe duke promovuar shoqëri shumetnike. Në anën tjetër, avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ia ka lexuar dëshmitarit një përkufizim të operacioneve psikologjike me të cilin dëshmitari është pajtuar. Duke u ndërlidhur me këtë, Emmersoni e ka pyetur

Abrahamsin nëse u kishin kushtuar rëndësi komunikatave të UÇK-së. Duke u përgjigjur në këtë pyetje, Abrahamsi ka thënë se komunikatat kanë qenë të rëndësishme pasi janë nxjerrë nga burimi zyrtar por, sipas tij, kjo është e ndryshme nga saktësia.

Më pas ai është pajtuar se mund të manipulohet lexuesi lidhur me forcat apo kjo mund të bëhet për të ndikuar tek armiku. "UÇK-ja përpigjej ta paraqesë veten si forcë e ligjshme ushtarake që luftonte për pavarësinë e Kosovës, për këtë s'ka asnjë dyshim. Janë përpjekur ta paraqesin veten si

forcë serioze ushtarake", ka thënë ai.

Po ashtu, ai ka thënë se Thaçi dhe Limaj kishin thënë se ka pasur drejtori ligjore, duke shtuar se "nëse ka ekzistuar një drejtori juridike e më pas del se s'ka ekzistuar, ka një numër shpjegues që njëri do të ishte se është operacion psikologjik".

Abrahamsi ka thënë se kjo mund të ishte pjesë e përkufizimit, informacion i përzgjedhur që synonte ta krijonte përshtypjen se UÇK-ja ishte më e organizuar sesa që ishte. Por, ai ka thënë se me kalimin e kohës ka parë më shumë uniformitet dhe

koherencë dhe një organizim më të mirë të tyre.

Në vazhdim, Abrahamsi është përgjigjur me "s'më kujtohet" kur i është thënë se nuk kanë pasur asnjë dëshmi të pavarur që të vërtetonte nëse ekzistonte një drejtori juridike në shtator, tetor dhe nëntor të '98-s.

Sa i përket çështjes së bashkëpunësorëve, dëshmitari ka thënë se fillimisht ka pasur faj shteti serb për politika diskriminuese kundër popullatës shqiptare, por ka theksuar se ekzistonte pikëpamja se UÇK-ja me deklarata etiketonte persona si tradhtarë, jobesnikë,

kolaboracionistë apo bashkëpunësorë dhe, sipas analizës së tij, kjo ka nxitur dhunën dhe i ka hapur rrugë dhunës.

Pas kësaj ka filluar dëshminë dëshmitari i 23-të me radhë i ZPS-së. Ai do ta japë dëshminë në seancë private. Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Katërshja e UÇK-së është deklaruar e pafajshme në raport me akuzat me të cilat është ngarkuar nga ZPS-ja.

Totaj nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin "Terre des hojmes Lausanne"

Prizren, 11 shtator - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me

Fondacionin "Terre des hojmes Lausanne" në Kosovë, për ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët në

situatë rruge, shërbime emergjente për fëmijët të cilët gjenden në rrezikshmëri të lartë dhe për fëmijët viktime të

abuzimit seksual. Këto shërbime do të ofrohen në Qendrën për Fuqizim dhe Mbrojtje të Fëmijës në Nashec (ish-"Pushimorja").



Fillojnë punimet për ndërtimin e rrugës unazore në drejtim të Llaushës



SKENDERAJ, 11 SHTATOR - Kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës unazore që lidh qytetin përkatësisht Lagjen II me Llaushën me dalje në rrugën rajonale në drejtim të Klinës. Me këtë rrugë do të krijohet qasje e lehtë dhe e

shpejtë për hyrje-daljet në qytet si dhe do të modernizohet sistemi rrugor i komunës.

Projekti në fjalë ishte premtim i qeverisjes Nura. "Punimet sot janë mbikëqyruar nga kryetari i komunës, Fadil Nura,

nënkryetari Sami Lushtaku, drejtori komunal Hamit Geci, përfaqësuesi i fshatit Llaushë, Arbër Geci, anëtarët e Kuvendit, Besart Rreci e Avdullah Geci, si dhe banorë të tjerë të fshatit Llaushë", ka njoftuar komuna e Skenderajt.

Asambletë e miratuan statutin e komunës së Malishevës

MALISHEVË, 11 SHTATOR - Në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të Kuvendit të komunës së Malishevës për vitin 2023, të cilën e udhëhoqi kryesuesi Argjend Thaçi, para asambletëve propozoi vetëm një pikë për shqyrtim, diskutim dhe miratim: draft-statutin e komunës së Malishevës të cilën e hartoi dhe draftoi komisioni profesional.

Pas një debati të gjerë të bërë nga asambletë, për disa sqarime që kërkuar prej anëtarëve të komisionit, për këto u përgjigjën nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi dhe drejtori për Administratë, Fatmir Ademaj. Në fund, me më shumë se dy të tretat e votave, asambletë e miratuan draft-statutin e komunës së Malishevës.



Komuna e Gjilanit me shkollën e agrobiznesit shpërndajnë katër krerë gjedhe për fermerët

GJILAN, 11 SHTATOR - Komuna e Gjilanit, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Shkollën e Mesme të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Sahit Baftiu", për herë të tretë kanë shpërndarë gjedhe për fermerët, përkatësisht katër krerë gjedhe në formë të subvencionimit. "Ne si Drejtori, së bashku me kryetarin e komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni, jemi të përkushtuar që fermerëve tanë t'u krijojmë kushte sa më të favorshme për mbarëvajtjen dhe kultivimin e gjedheve të racës simental, një racë e cila ka potencial të lartë të qumështit

dhe mishit", ka thënë drejtori për Bujqësi në Gjilan, Bajram Isufi.

Ai ka falënderuar menaxhmentin e shkollës për bashkëpunimin konstruktiv dhe për kultivimin e kësaj race, duke i uruar të gjithë fermerët përfitues dhe duke mbetur me shpresë që këto gjedhe të ruhen e të kultivohen në mënyrë që kjo racë të mbarështohet që të përdoret për rritjen e mirëqenies së familjeve tona. Isufi ka bërë me dije, gjithashtu, se së shpejti komuna e Gjilanit do ta bëjë shpërndarjen edhe të 120 krerëve lopë të racës simental për fermerët e Gjilanit.



Hapet barnatorja në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Komoran



DRENAS, 11 SHTATOR - Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Komoran (QMF) edhe zyrtarisht është hapur barnatorja, në të cilën qytetarët do të mund të shërbehen me barna të listës esenciale. Për ta përruar këtë shërbim ka

marrë pjesë nënkryetari i komunës, Arben Shala, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Lumnije Krapit, dhe shefin e kabinetit të kryetarit, Skender Berisha. Me hapjen e kësaj barnatoreje brenda

objektit të QMF-së në Komoran qytetarëve do t'u lehtësohet shërbimi dhe nga sot banorët e Komoranit me fshatra në rrethinë mund të përfitojnë nga ky shërbim me fillim nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Kurti: Synimi ynë është t'i çmontojmë strukturat që mundësojnë pabarazi

PEJË, 11 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në një panel diskutimi në kuadër të Shkollës Verore mbi Gjiminë, Ekonominë dhe Politikën në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka". Me temën kyçe "Barazia gjinore", kryeministri Kurti theksoi para të pranishmëve se si institucione të shtetit kemi përgjegjësi për të nxitur ndjenjën e solidaritetit midis qytetarëve.

Ai ka potencuar se kjo kërkon përfshirje aktive të të gjithë anëtarëve të shoqërisë. "Kur flasim për emancipim nuk bëhet fjalë veç për çlirim të grave, por edhe për edukimin e burrave. Le t'i edukojmë burrat, që ata të jenë aleatë për luftën për barazi gjinore. Gratë nuk është e thënë ta bëjnë këtë betejë vetëm. Duhet ta bëjnë bashkë me burrat, prandaj nevojitet emancipim, edukim i burrave për rëndësinë e barazisë gjinore", u shpreh kryeministri.

Për mundësi dhe të drejta të barabarta, vazhdoi kryeministri, si qeveri kanë vënë në theks rëndësinë e bursave në kuadër të programit STEM-Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë, për të eliminuar një hendek social në tregun e punës. Gjithashtu shtoi se për vetëm 21

muaj nga 37 mijë e 350 vende pune, 50.3 për qind janë gra të punësuar, derisa më shumë sa gjysma e atyre që kanë përfituar nga "Superpuna", po ashtu janë gra.

Programi "Qeveria për familjen" ka mundësuar që 603 gra të jenë përfituese, ndërkaq janë mbështetur mbi 34 mijë gra lehona, me ç'rast 90 mijë gra kanë hapur llogari bankare për herë të parë.

Kryeministri Kurti përsëriti se ne nuk i shohim gratë vetëm si nëna ose si lehona, mirëpo gratë duhet të kenë sa më shumë kohë për vetën e tyre dhe mbështetja financiare për to dhe për fëmijët kontribuon ndjeshëm për të gjithë.

Teksa shtoi se "deri më tani kemi mbështetur biznese që janë në pronësi të grave me vlerë të subvencionimit afër gjysmë milion euro, kurse vlera e kreditimit të mundësuar tejkalon tre milionë euro, e në bujqësi për vitin 2021 kemi ndarë subvencione për 1 325 gra përfituese".

Ai tha se synimi i qeverisë është t'i çmontojmë strukturat që ndihmojnë në përdorimin e pabarazisë, përderisa duhet të përipiqen për pjesëmarrje aktive,



ku gratë jo vetëm të kenë një vend në tryezë, por edhe një zë në vendimmarrje. "Andaj, le të mos mjaftohemi me kaq, le të imagjinojmë një botë ku barazia, drejtësia nuk janë aspirata, por realitete të jetuara. Veprimet tona le të udhëhiqen nga parimet e barazisë ekonomike e të solidaritetit shoqëror, lirive dhe të drejtave, përfshirjes dhe

pjesëmarrjes aktive", përfundoi ai. Shkolla Verore mbi Gjiminë, Ekonominë dhe Politikën është një program pesëditor që bashkon studentë dhe liderë të rinj të interesuar për ta eksploruar ndërlidhjen mes gjinisë dhe ekonomisë.

NDI do të organizojë Shkollën Verore në muajin shtator për një grup të përzgjedhur të rinjsh.

Programi do të rekrutojë 25-30 të rinj nga mosha 18 deri në 29 vjeç. Nëpërmjet leksioneve, seminareve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të familjarizohen me konceptet dhe teoritë kryesore të ekonomisë feministe dhe do të fitojnë një kuptim më të thellë se si gjinia ndikon në sistemet dhe rezultatet ekonomike.

Bie numri i personave që kanë marrë paga pa qenë në marrëdhënie pune, 51 raste dërgohen në prokurori

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Gjatë vitit të kaluar numri i personave që kanë marrë paga pa qenë në marrëdhënie pune sipas Marrëveshjes së Brukselit ka rënë në 129 dhe se janë dërguar 51 raste në Prokurori të Shtetit, ka konfirmuar auditorja e përgjithshme Viora Spanca në një konferencë për medie, duke shtuar se vlera e pagesës për këta punonjës ishte rreth 800 euro në vit. "Gjatë vitit 2022 përsëri ishin realizuar pagesa prej 792 mijë eurosh të komunitetit serb të angazhuar sipas Marrëveshjes së Brukselit, të cilët nuk e kanë vijuar punën në kuadër të ministrive përkatëse. Nga 199 punonjës sa ishin në vitin e kaluar, këtë vit kanë mbetur 129 punonjës të shpërndarë në katër



ministri, ajo e Mjedisit me 64 punonjës, e Tregtisë me 25, e Punëve të Brendshme me 20 dhe ajo e Komuniteteve me 20 punonjës, të cilët janë paguar

gjatë tërë vitit. 52 punonjës ishin paguar për gjysmën e parë të vitit 2022", ka thënë Spanca, duke shtuar se Ministria e Arsimit kishte 32 punonjës të

cilët në pjesën e dytë të vitit u kishte siguruar kushte dhe kishte vijueshmëri në punë si dhe Ministria e Kulturës për 20 punonjës, në gjysmën e dytë të

vitit ua kishte ndërprerë pagesat. Sipas Spancës, në Prokurorinë e Shtetit janë dërguar 51 raste të dyshimta dhe dy raporte për shkak të çështjeve të ndërlidhura. "Janë dërguar 51 raste të dyshimit, të cilat i kemi dërguar te Prokurori i Shtetit për analizë dhe hetime të mëtejshme. Po ashtu janë dërguar dy raporte për shkak të çështjeve të ndërlidhura", tregoi ajo.

Spanca ka theksuar se rastet e identifikuar janë kryesisht nga fusha e prokurimit publik, si procesi i prokurimit, lidhja e kontratave, shpenzimet në kategorinë e investimeve e ku janë identifikuar 36 raste. "Tetë raste janë identifikuar në kategorinë e subvencioneve e transfereve dhe shtatë raste në fushën e punësimit", ka përfunduar Spanca.

Emin Hoxhaj emërohet drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka emëruar Emin Hoxhajn drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e Informacionit të

Klasifikuar. Ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hoxhaj ka qenë pjesë e Policisë së Kosovës nga viti 2001, duke

shërbyer në kapacitete të ndryshme, përfshirë si shef i Njësisë së Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, së fundmi shef i

Njësisë së Hetimeve të Përgjithshme në Gjakovë. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës.



Rritja ekonomike në BE, më e ngadalshme sesa pritej

BRUKSEL, 11 SHTATOR - Ekonomitë e 27 vendeve të Bashkimit Evropian do të vazhdojnë të regjistrojnë rritje ekonomike më të ngadalësuar sesa është pritur për shkak të inflacionit të lartë, ka thënë Komisioni Evropian në parashikimin e publikuar të hënën. Fillimisht Komisioni ka parashikuar rritje të ekonomisë së bllokut për 1 për qind më 2023, por situata aktuale tregon për rritje 0.8 për qind. Parashikimi për vitin 2024

është ulur në 1.4 për qind nga 1.7 për qind sa ka qenë fillimisht. Sipas raportit, ngadalësimi është shënuar nga ulja e kërkesës për shkak të normave të larta të inflacionit.

“Ekonomia e BE-së është përballur me dy situata të rënda: pandeminë e koronavirusit dhe luftën e Rusisë në Ukrainë. Shkalla e lartë e inflacionit e ka bërë të veten, ndonëse tani ka nisur të bjerë”, ka thënë zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Valdis

Dombrovskis.

Shkalla e inflacionit pritet të arrijë në 6.5 për qind më 2023 dhe 3.2 për qind më 2024.

Në Eurozonë çmimet e produkteve të konsumit pritet të rriten për 5.6 për qind më 2023 dhe 2.9 për qind më 2024.

Lufta e Rusisë që vazhdon të zhvillohet në Ukrainë, shkalla e lartë e normave të interesit, inflacionit dhe ndikimi i motit ekstrem, vazhdojnë të përbëjnë rrezik për ekonominë e bllokut, ka thënë Komisioni Evropian.



Kosova dhe Izraeli nënshkruajnë deklaratën e përbashkët për bashkëpunim në fushën e turizmit

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ministri i Turizmit të Izraelit, Haim Katz, u mirëprit në ambientet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nga ministrja Rozeta Hajdari. Dy ministrat homologë gjatë këtij takimi nënshkruan deklaratën e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Ministrisë së Turizmit të Shtetit të Izraelit për bashkëpunim në fushën e turizmit, e cila ka për qëllim forcimin e lidhjes ndërmjet dy vendeve duke ndihmuar në zhvillimin e turizmit në përputhje me parimet e respektit reciprok dhe barazisë.

Ministrja Hajdari tha se ky është një shans i jashtëzakonshëm për të eksploruar shumë fusha të reja bashkëpunimi, përfshirë pjesëmarrjen në ekspozita, panaire, konferenca dhe ngjarje të tjera që do t'i promovojnë bukuritë natyrore dhe kulturën e të dyja vendeve.

Deklarata e përbashkët parasheh edhe shkëmbimin e



informacionit mbi inovacionin dhe digjitalizimin e turizmit dhe ekspertizës me synimin për të krijuar një partneritet të qëndrueshëm me theks në sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe

sipërmarrjet fillestare që operojnë në industrinë e turizmit, po ashtu edhe shkëmbimin e të dhënave dhe statistikave që do ta përmirësojnë përvojën e udhëtimit për të dyja vendet.

Nxitja e bashkëpunimit institucional ndërmjet Autoriteteve Kombëtare të Turizmit dhe nxitja e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet agjencive të udhëtimit dhe institucioneve të tjera në

fushën e turizmit është gjithashtu e rëndësishme së veçantë.

Po ashtu, Deklarata e Përbashkët parasheh edhe nxitjen e bashkëpunimit në kuadër të Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO) si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të lidhura me turizmin si dhe në fushën e edukimit turistik, duke nxitur shkëmbimin e informacionit përkatës me qëllim krijimin e kushteve për të mundësuar shkëmbimin e përvojës praktike në fushën e edukimit, trajnimit dhe të mësuarit, me theks të veçantë në ngritjen e aftësive dhe rikualifikimit.

Kjo ngjarje është një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit të ngushtë në fushën e turizmit në mes të Republikës së Kosovës dhe Izraelit.

Pas vizitës që ministrja Rozeta Hajdari muaj më parë kishte realizuar në Izrael, ministri Katz po realizon një vizitë në vendin tonë. Ai do të zhvillojë takime të ndara me krerët më të lartë shtetërorë.

FMN-ja kërkon nga G20-a t'i përmbushë detyrimet financiare për klimën

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Shefja e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Kristalina Georgieva, theksoi urgjencën e rritjes së burimeve të alokuara për organizmin financiar botëror përpara fundit të këtij viti. Georgieva u bëri thirrje vendeve anëtare të G20-s që ta përmbushin angazhimin e tyre për të siguruar 100 miliardë dollarë në vit për fondet e klimës.

Gjatë samitit në Indi, G20-a publikoi një deklaratë ku zotohej t'i trajtojë dobësitë e borxhit me të cilat përballen vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme në një mënyrë

të plotë, gjithëpërfshirëse dhe sistematike.

Në një deklaratë përmblylëse pas samitit dyditor, Georgieva deklaroi se anëtarët e G20-s duhet ta japin shembullin duke përmbushur premtimet e tyre prej 100 miliardë dollarësh në vit për financimin e klimës dhe kjo duhet të arrihet duke forcuar bankat e zhvillimit shumëpalësh.

Vendet, gjithashtu, duhet t'i mobilizojnë burimet e brendshme për ta financuar dhe menaxhuar tranzicionin e gjelbër përmes reformave tati-more, shpenzimeve publike efektive dhe efikase, institu-

cioneve të forta fiskale dhe tregjeve të borxhit lokal.

Ajo i kërkoi grupimit ta forcojë rritjen botërore të sigurisë financiare. “Për ta bërë ekonominë globale më të fortë dhe më elastike në një botë më të prirë ndaj goditjeve, është jetike të arrihet një marrëveshje për t'i rritur burimet e kuotave të FMN-së përpara fundit të vitit”, tha Georgieva, duke shtuar se një pakt i tillë do t'i siguronte burimet e nevojshme për mbështetjen pa interes të Fondit për vendet më të varfra përmes programit për Reduktimin e Varfërisë dhe



Rritjen Ekonomike. Samiti i G20-s u zotua gjithashtu për t'i forcuar dhe reformuar bankat e zhvillimit

shumëpalësh, duke pranuar një propozim për ta rregulluar më shumë tregun e kriptovalutave në mbarë botën.

Kontinenti i grushteve të shtetit: Pse Afrika është gjithmonë e paqëndrueshme

Ekziston një datë e saktë e fillimit për paqëndrueshmërinë që po mbërthen Afrikën. Ishte 21 marsi i vitit 2012, dita në të cilën në Bamako, kryeqyteti i Malit, disa ushtarë nga baza ushtarake Kati morën pushtetin dhe rrëzuan presidentin e atëhershëm Amadou Toumani Touré. Që atëherë, ushtritë janë bërë lojtarë kyç në të gjithë rajonin e Sahelit. Dhe sot “era e grushteve të shtetit” duket se po përhapet në një pjesë të madhe të kontinentit.

Sigurisht, Afrika nuk po i përjeton vetëm tani përvojat e grushteve të shtetit. Por në dekadën e fundit ndërhyrja e ushtrisë është theksuar shumë. Me implikime gjeopolitike brenda dhe jashtë kontinentit, që aktualisht janë të paparashikueshme.

Nga Mali në Republikën e Afrikës Qendrore, shenjat e para të paqëndrueshmërisë në Sahel

Pamjet e flamujve rusë në Niamey, kryeqyteti i Nigerit, me rastin e grushtit të shtetit të fundit në vendin afrikan kanë shkaktuar jo pak bujë. Në veçanti, u krijua përshtypja e një dueli mes Moskës dhe Perëndimit e transferuar në Afrikë, dhe me opinionin publik vendas të njëanshëm në favor të Kremlinit në një funksion antiperëndimor dhe antikolonial. Megjithatë, në realitet, kriza në Sahel ka origjinë të largët. Siç u përmend, duhet t'i kthehemi grushtit të shtetit në Mali të vitit 2012. Me atë rast, ndërhyrja ushtarake kishte arsye thjesht të brendshme. Vendi po përballej me rebelimin e Azawadit, rajoni verior me një shumicë Tuareg që kishte shpallur shkëputjen. Një kontekst ndoshta i favorizuar edhe nga fundi dramatik i regjimit të Gadafit në Libi.

Ushtria maliane, për shkak të menaxhimit të dobët të konfliktit në veri të vendit, ndërmori veprime në mars 2012 kundër presidentit të atëhershëm Touré. Juntat e njëpasnjëshme ushtarake dhe qeveritë e lindura pas periudhëve të tranzicionit të trazuar nuk shprehën menjëherë një retorikë anti-franceze dhe antiperëndimore. Përkundrazi, duke pasur parasysh përparimin e grupeve xhihadiste në Azawad, të favorizuara nga kaosi i atyre muajve, filloi një bashkëpunim me Parisin për dërgimin e trupave franceze në vend. Kështu filluan operacionet Serval dhe Barkhane, objektivi i të cilave ishte eliminimi i kërcënimit islamist në Sahel. Edhe në Republikën e Afrikës



Qendrore fqinje, ku në vitin 2013 koalicioni Seleka rrëzoi ish-presidentin Francois Bozizé, ndryshimi i papritur i regjimit kishte një origjinë krejtësisht të brendshme. Konfliktet etnike-politike të lashta të Afrikës Qendrore dhe kurrë të pazgjdhura luajtën një rol vendimtar në këtë rast.

Dobësia e shteteve sub-Sahariane

Pasi ushtria mori pushtetin në Bamako, mesazhi ka kaluar në të gjithë Sahelin se problemet serioze të zonës mund të zgjidhen me një përmbyse të papritur të sistemit politik. Kjo është arsyeja pse shumë ushtri kanë ndërhyrë, duke marrë edhe mbështetje nga opinioni publik. Në prill 2019, kur ushtria rrethoi shtëpinë e presidentit të atëhershëm sudanez Omar Al Bashir, njerëzit dolën në rrugë për të festuar. Në Khartoum shumë të rinj kishin ndjenjën se kishin arritur demokracinë falë veprimit të ushtarëve. Këto janë të njëjtat skena gëzimi të para disa vite më vonë në Ouagadougou dhe Niamey. Në shtator 2021, kur presidenti i atëhershëm Alpha Condé i Guinesë njoftoi synimin e tij për të ndryshuar kushtetutën dhe për të vazhduar me një mandat tjetër, ushtria vendosi të vërë në veprim një grusht shteti. Megjithatë, ndërhyrja e ushtrive nënkupton një dobësi politike dhe strukturore të vendeve të

ndryshme të përfshira. Në të vërtetë, zbatimi i një grushti shteti tregon mungesën e një shoqërie civile të aftë për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes, si dhe mungesën e një alternative të vlefshme, brenda aparateve shtetërore, ndaj intervencionimit të ushtrisë.

Kjo u pa edhe në Çad në prill 2021, kur presidenti Idriss Déby u vra në vijën e frontit, ndërsa rebelët që hynin nga Libia kërcënuan kryeqytetin N'Djamena. Pas vdekjes së tij, gjeneralët imponuan emërimin e djalit të tij Mahamat Déby si kreun e ri të shtetit. Kështu kushtetuta u pezullua dhe përsëri ushtria u pa si aktori i vetëm i aftë për të ruajtur stabilitetin. Problemet ekonomike që mbajnë mbërthyer kontinentin Dobësia e vendeve afrikane ka mbi të gjitha origjinë ekonomike. Dhe pretendimet kryesore të popullsisë të ndryshme të prekura nga ndërhyrjet e grushtit të shtetit janë të një natyre ekonomike. Në Mali, si dhe në Niger, Burkina Faso dhe në pjesën më të madhe të brezit sub-Saharan, mijëra njerëz jetojnë nën kufirin e varfërisë. Situata është përkeqësuar në dekadën e fundit. Sidomos në rajonet më të largëta të vendeve në fjalë, është e pamundur të gjejsh punë dhe mjete për të mbështetur familjen. Një rrethanë e cila, veçanërisht në Sahel, po favorizon ndër të tjera prozelitizmin me karakter xhihadist dhe shfaqjen e grupeve kriminale të përkushtuara ndaj kontrabandës.

Një rreth vicioz që është i vështirë për t'u zgjidhur. Paqëndrueshmëria shkakton varfëri dhe, nga ana tjetër, varfëria nxit më shumë paqëndrueshmëri. Opinioni publik në Sahel e ka drejtuar gishtin si ndaj sistemeve të tij politike ashtu edhe ndaj ndikimit të aktorëve ndërkombëtarë. Ndaj edhe mbështetja e gjerë që iu dha ushtarakëve që erdhën në pushtet dhe përhapja e “erës së grushtit të shtetit” në rajon.

Ndjenja antiperëndimore

Retorika antiperëndimore, brenda këtij zinxhiri ngjarjesh, është e kohëve të fundit. Edhe një herë vendi nga i cili filloi gjithçka është Mali. Këtu, përkeqësimi i kushteve të sigurisë u dha qytetarëve një perceptim shumë negativ për praninë franceze. Parisi është akuzuar në disa raste për ambicie imperialiste, të fshehura nga vullneti zyrtar për të luftuar kundër terrorizmit. Që pranë zgjedhjeve të 2018-ës, ato që kurorëzuan Ibrahim Boubacar Keita-n si president të ri, shumë tubime iu referuan gjerësisht mundësisë së çlirimit nga Franca.

Në këtë drejtim janë shtyrë edhe autoritetet fetare. Midis tyre, për shembull, Imam Mahmud Dicko, kreu i keshillit islamik të Malit. Fjalimet e tij janë fokusuar shpesh te keqmenaxhimi i shtetit, te paaftësia e klasës politike, por edhe te dëmet që rrjedhin nga

operacionet franceze dhe në përgjithësi nga ndikimi i Parisit në vend. Një retorikë sa antiperëndimore aq edhe antikoloniale, e ndjekur më vonë nga politikanë të ndryshëm dhe nga vetë ushtria.

Kjo është arsyeja pse grushti i shtetit i gushtit 2020 kishte një konotacion të ndryshëm nga ai i tetë viteve më parë. Gjenerali përgjegjës për grushtin e shtetit, Assimi Goita, ka folur hapur për mundësinë e një largimi përfundimtar nga sfera franceze e influencës. Rrethanë e rikonfirmuar me rastin e një grushti të dytë, të kryer edhe nga Goita në maj 2021. Përfundimi i operacionit Barkhane dhe afrimi me Rusinë dhe kompaninë Wagner, i shprehur me votën e Bamakos në përputhje me Moskën në rezolutat e ndryshme për luftën në Ukrainë, dhanë demonstrim të mëtejshëm të politikës së re antiperëndimore. Jo vetëm në Mali, por edhe në vendet fqinje.

Linja antifranceze, e cila kulmoi me urdhrin për braktisjen e territorit që iu komunikua trupave në Paris, u përkrah edhe nga junta ushtarake në Burkina Faso, e cila në vitin 2022, me një tjetër grusht shteti, mori pushtetin në dëm të ish-presidentit Roch Kabore. Për rrjedhojë, grushti i shtetit në Niger përfaqësoi vetëm episodet e fundit që lidhen me rritjen e një intolerance të thellë ndaj atdheut mëmë kolonial, përkatësisht Francës, dhe ndaj ndikimit perëndimor.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Mediet serbe kërkojnë dënimin e Dakut për tatuazhin 'Katana 138'

TIRANË, 11 SHTATOR - Mirlind Daku ishte protagonist i kombëtares shqiptare, duke shënuar golin e qetësisë ndaj Polonisë, pak minuta pasi hyri në fushën e blertë. Sulmuesi nga Kosova festoi duke e hequr fanellën, ndërsa

në shpinën e tij u pa tatuazhi "Katana 138", kushtuar komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Agim Ramadani - "Katana", i rënë në Betejën e Koshares, i shpallur më pas hero kombëtar. Tatuazhi ngriti

shumë pluhur në publikun serb dhe mediet e shtetit fqinj po pyesin nëse UEFA do të reagojë për këtë dhe nëse do ta dënojë sulmuesin e Kosovës. Nga ana e tij, futbollisti shqiptar nga Kosova dha një mesazh të

fuqishëm dhe emocionues pas lojës. "Golin ua dedikoj të gjitha viktimave në Kosovë që dhanë gjithçka për atdheun e tyre, që sot të luajmë këtu dhe t'i bashkojmë të gjitha trevat shqiptare", ka deklaruar Daku.



Kosova sonte përballët me Rumaninë, Gliha dhe Vojvoda presin rezultat pozitiv

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ekspedita e Kosovës në futboll të hënën ka arritur në Bukuresht ku edhe ka kryer stërvitjen e fundit para ndeshjes me Rumaninë, e vlefshme për eliminatorët e Kampionatit Evropian. Përzgjedhësi i Kosovës, Primozh Gliha në konferencë për media ka deklaruar se të dyja skuadrat kanë nevojë për pikë, por që se Kosova ka udhëtuar me synim për të marrë rezultat pozitiv nga ndeshja që do të zhvillohet në stadiumin "National Arena".

"Pres rezultat pozitiv dhe do të japim gjithçka për të arritur këtë. Luajmë kundër një ekipi që ka shumë lojtarë teknikë, por edhe ne kemi lojtarë të mirë dhe të luajmë në klube të mëdha. Jemi përgatitur mirë dhe ndihemi shumë mirë para kësaj ndeshje. Jam i bindur se do të jetë një lojë e shkëlqyeshme, sepse të dyja ekipet kemi nevojë për pikë", ka thënë Gliha. Optimist për ndeshjen ndaj rumunëve është shfaqur edhe Mërgim Vojvoda. Ky i fundit ka thënë se rezultati i arritur ndaj Zvicrës e ka ngritur moralin tek ekipi. I pyetur nga gazetari

rumun rreth provokimeve të tifozëve rumun në Prishtinë dhe mundësisë së përsëritjes së provokimeve të tilla në Bukuresht, Vojvoda është përgjigjur: "Mjafton ta shihni këtë logo në zemrën tonë, është flamuri i Kosovës dhe ne e përfaqësojmë këtë shtet dhe askënd tjetër. Ne jemi Kosova. Jemi të lindur nga lufta dhe do të bëhemi më të fortë se guri". Ndeshja Rumani-Kosovë zhvillohet sonte (e martë) në orën 20:45. Rumania është në pozitën e dytë në Grupin I, me 9 pikë, derisa Kosova është në kuotën e 4 pikëve.



Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030', Rama: Do të ndërtojmë ambiente të reja sportive

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka premtuar ambiente të reja sportive në kryeqytet për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030". Rama ka thënë se organizimi i lojërave mesdhetare në Kosovë është një fitore e të gjithëve, derisa ka shtuar se kjo ngjarje do t'ia hapë një derë të madhe të gjithë sportit në vend. "Ne do ta optimizojmë infrastrukturën ekzistuese dhe në mënyrë strategjike do të shtojmë objekte të reja. Po, do të ndërtojmë ambiente të reja sportive. Angazhimi ynë shtrihet edhe përtej këtyre lojërave. Do ta ndërtojmë stadiumin olimpiq të premtuar



me të gjithë qendrën sportive, me qëllim që të krijojmë një trashëgimi të qëndrueshme infrastrukture që do të gëzojmë edhe përtej vetë



ngjarjes në shërbim të fuqizimit të atletëve tanë", ka thënë Rama. "Kanë mundësi të shkëlqejnë kudo në arenat sportive

ndërkombëtare. Për më tej do ta shfrytëzojmë potencialin e stadiumeve dhe të palestrave ekzistuese në të paktën 10 komuna të ndryshme të Kosovës", ka shtuar Rama. Rama ka thënë se Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030" do të jenë ngjarja më e madhe ndërkombëtare që pritet të zhvillohet në Kosovë. "Për herë të parë një qytet jobregdetar, Prishtina jonë, bëhet mikpritëse. Do të jetë kjo hera e parë në histori të Lojërave Mesdhetare ku do t'i bashkojnë forcat dy shtete, disiplina e lundrimit thelbësore në lojërat mesdhetare do të luhet në brigjet e Durrësit. Ky partneritet strategjik me vëllezërit tanë në

Shqipëri e krijon një platformë barazie për të gjitha vendet pjesëmarrëse. Përmes tij synojmë t'i frymëzojmë të tjerët përtej kufijve dhe ta përqafojmë frymën e bashkëpunimit sportiv që nuk njih asnjë kufij. Rëndësia historike e edicionit të 21-të lojërave mesdhetare shkon përtej këtyre risive. Ato do të jenë ngjarja më e madhe ndërkombëtare që pritet të zhvillohet brenda vendit tonë qysh prej pavarësisë e këndeje. Kjo ngjarje do t'ia hapë një derë të madhe të gjithë sportit kosovar duke i mundësuar më tej çdo federate me qenë nikoqire e ngjarjeve ndërkombëtare në disiplinën përkatëse", ka shtuar Rama.


Shqipërisë në tetor i bashkohet edhe Thaqi

TIRANË, 11 SHTATOR - Shqipëria ka mbyllur me sukses dy ndeshjet kualifikuese të Evropianit 2024, duke marrë katër pikë. Një barazim në Pragë dhe fitorja në Tiranë ndaj Polonisë, i kanë

ngjitur kuqezinjtë në vendin e parë në klasifikim. Sakaq, për kuqezinjtë debutuan edhe dy lojtarë të rinj. Mirlind Daku dhe Arbnor Muja morën minuta në të dyja ndeshjet, aty ku Daku

arriti të shënonte ndaj Polonisë golin e dytë të ndeshjes. Në tetor pritet që edhe Armend Thaqi të jetë pjesë e Shqipërisë. Mbrojtësi 30-vjeçar do të jetë pjesë e Kombëtares kuqezi. Lajmin e ka dhënë

trajneri Bylbyl Sokoli i cili u shpreh se Thaqi është pranë kalimit te Shqipëria. Thaqi mbush 31 vjeç në tetor dhe me Ballkanin ka qenë ndër më të spikaturit. Luan si mbrojtës i djathtë.



Kosova humbi dy ndeshje në Lojërat Mesdhetare në rërë

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në Hendboll në Rërë i ka luajtur edhe dy ndeshje në kuadër të Lojërave Mesdhetare në Rërë. Në Heraklion të

Grequisë, djemtë “dardanë” fillimisht u përballën me Kroacinë. Pësuan 2:0 (30:10, 26:12). Kosova luajti me Qipron dhe pësoi po 2:0 (20:11, 26:13). Në të dyja

ndeshjet në shprehje erdhi përvoja në hendbollin në rërë. Në disa çaste Përfaqësuesja e Kosovës shfaqti cilësi, por jo mjaftueshëm sa për të

shënuar fitore. Kjo është gara e parë e Kosovës në hendbollin në rërë. Lojtarët janë përzgjedhur nga skuadrat e hendbollit të rregullt dhe po fitojnë



Sylvinho: Është herët për të festuar, kemi edhe tri finale

TIRANË, 11 SHTATOR - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, është shfaqur më se i lumtur pas fitores ndaj Polonisë (2-0). Ai i ka falënderuar tifozët për mbështetjen fantastike dhe ambientin e krijuar. Tekniku brazilian analizoi ndeshjen ndaj polakëve që i afron edhe më shumë kuqezinjtë drejt kualifikimit.

Çfarë i keni bërë kësaj skuadre që arrin të ngrehë në pesë zemrat e gjithë shqiptarëve?

Dua t'u bëj një kompliment të gjithë tifozëve që kishim sot në stadium, që ishin të mrekullueshëm. Krijuan një ambient të jashtëzakonshëm, duke na ndihmuar shumë të gjithëve ne, ndaj kjo është një fitore e të gjithë popullit shqiptar. Ishte shumë e rëndësishme të mos humbim dhe për fat ia dolëm, pro duhet të vijojmë të bëjmë kujdes, pasi tani kemi edhe Moldavinë nga mbrapa. E dinim historinë e kundërshtarit, por mendoj që e kemi merituar fitoren sot.

Vuajtëm pak në fillim, por goli i anuluar i tyre na zgjoi...

Ishim vendosur mirë në fushë, por na mungonte një pasim i fundit përpara. Më pas e morëm veten mirë dhe bëmë një ndeshje shumë të mirë, me shumë zemër dhe shumë shpirt në fushë.

Mitaj dhe Hysaj thuajse nuk u panë asnjëherë të dalin në fundore. Nuk ia dolën apo ishte këshilla juaj?

Jo, nuk ia dolën. Si Hysaj, edhe Mitaj, nuk kishin mundësi të shkonim shumë përpara, pasi kishin përballë lojtarë shumë të fortë, që nëse u lë hapësira, të vrasin.

Polonia në bëri një presing të lartë. Si do ta zgjidhnit këtë problem nëse nuk do të kishim super gol të Asanit?

Ndeshja zgjidhet për 90 minuta. Në fillim nuk ishte një moment i



mirë për ne, por e morëm veten shpejt. Ata na vunë në vështirësi, por me disa ndryshime, morëm më shumë hapësirë. Ata bënë presin të lartë, por ishin të paqartë në finalizim, në pasimet finale.

Një skuadër cinike, që fiton edhe kur nuk krijon shumë...

Ne punojmë shumë në pjesën e organizmit, por pas kësaj qëndron cilësia e lartë e futbollistëve. Kemi lojtarë të shpejtë, të fortë, që shënojnë si Barjami, Cikallesi, Uzuni, Muçi, Bajrami etj., etj. Janë lojtarë që bëjnë tranzicion shumë të shpejtë dhe janë të aftë të shënojnë gola. E di mirë atë shprehje dhe pas kaq shumë vitesh në futboll, jam plotësisht i bindur që ka të drejtë. Lojtarët hyjnë me dëshirë në fushë dhe janë të gjithë bashkë. Ne menaxhojmë grupin dhe ata janë gjithmonë gati për të dhënë maksimumin.

A do të jetë e vështirë t'i gesh vend edhe Brojës në tetor?

Është një futbollist i madh dhe shpresojmë ta kemi shumë shpejt në skuadër. Është një dëmtim i rëndë, që kërkon 9 muaj rikuperim. Do të shkojmë në Londër ta ndjekim dhe të flasim me të. Nëse do të jetë në gjendje, atëherë nuk e kemi problem t'i gjejmë vend. Por nuk do të nxitohemi dhe duhet të tregojmë kujdes.

Çfarë u the lojtarëve në dhomat e zhveshjes pas ndeshjes?

U thashë se është dita jo vetëm e tyre, por e të gjithë shqiptarëve, të gjithë duhet të fitojmë. Ne kemi një skuadër të fortë dhe kemi fituar, sepse e kemi merituar. Por në fund u thashë që nuk ka përfunduar asgjë. Është një grup i vështirë dhe ka akoma shumë momente të vështira. Na presin edhe tri finale dhe duhet ta trajtojmë çdo ndeshje me rëndësinë maksimale.

SHKURT

Lewandowski: Ndaj Shqipërisë ishte ndeshje për turp

Kapiteni i Kombëtares së Polonisë, Robert Lewandowski, ka thënë se humbja nga Shqipëria është një turp i madh. Kuqezinjtë triumfuan me rezultat 2-0 dhe tash janë të parët në grup. Ylli i Barcelonës nuk arriti në asnjë çast ta rrezikoj portën shqiptare, pasi Gjimshiti dhe Ismajli u përkuqdesën në mënyrë të jashtëzakonshme për të. “Ditët e fundit iu kushtuan kryesisht kombëtares, pasi në shtator luajtëm dy ndeshje të eliminatorëve të ‘Euro 2024’. E para, edhe pse pas një loje të dobët, përfundoi me fitoren 2-0 ndaj Ishujve Faroe. Ndeshja tjetër është një turp i plotë me Shqipërinë, pasi humbëm 2-0”, ka thënë Lewandowski.

Polonia shkarkon trajnerin Santos

Nuk reziston më shumë se 24 orë pas humbjes së Tiranës, trajneri Fernando Santos në stolin e Polonisë. Tekniku portugez i Polonisë është shkarkuar nga detyra për shkak të rezultateve të dobëta. Pesë ndeshje nga të cilat tri humbje dhe dy fitore dhe vendi i katërt në Grupin E të eliminatorëve të “Euro 2024” i kanë shtyrë drejtuesit e federatës polake ta marrin vendimin ekstrem menjëherë pasi Santos shkeli në Varshavë pas ndeshjes me Shqipërinë. Pas disfatës 2-0 në “Arenën Kombëtare”, Polonia i komplikoi shumë pozitën në Grupin E, ku ka zbritur në vendin e katërt dhe tashmë duhet t'i fitojë tre ndeshjet e mbetura për ta synuar evropianin e Gjermanisë.

Djoković triumfon në ‘US Open’

Novak Djoković bëri histori në New York dhe në “US Open”. Serbi u bë tenisti i vetëm në historinë e këtij sporti që arriti 24 Grand Slame, dy më shumë se Rafael Nadal i cili është ndalur në 22. Djoković hakmerret ndaj rusit Daniil Medvedev duke e mposhtur në tri sete në finalen e madhe të US Open. Numri një i botës fitoi me rezultatin 6-3, 7-6 dhe 6-3 në një ndeshje që u luajt për 3 orë e 17 minuta. Ai madje është i pari në Grand Slams, Masters dhe ATP Finals. 2023 është viti i katërt në karrierën e tij që ai fiton 3/4 Grand Slam të “US Open” pas 2011, 2015 dhe 2021.

Al Arabi paraqet Verratin

Al Arabi ka njoftuar se ka nënshkruar me mesfushorin italian Marco Verrati, nga Paris Saint-Germaini, për 50 milionë euro. Verrati ka nënshkruar një ujdë, ku do të përfitojë rreth 35 milionë euro në sezon. PSG-ja e kishte transferuar Verratin për 12 milionë euro në vitin 2012. Kështu gjiganti francez përfitoi 38 milionë euro nga shitja e mesfushorit, i cili u bë lojtari me më së shumti trofe te parisienët.

Rubiales pas dorëheqjes: Do ta mbroj nderin tim, jam i pafajshëm



MADRID, 11 SHTATOR - Luis Rubiales ka dhënë dorëheqje si president i Federatës Spanjolle të Futbollit (RFEF) pas skandalit për puthjen e Hermosos. Ndërsa ka reaguar në rrjetet sociale pas këtij vendimi, Rubiales theksoi se

është “i pafajshëm”. “Do ta mbroj nderin tim. Do ta mbroj pafajësinë time. Kam besim tek e ardhmja. Kam besim tek e vërteta”, ka shkruar Rubiales. “Unë kam besim në të vërtetën dhe do të bëj gjithçka që kam në dorë për të fituar. Vajzat e

mia, familja ime dhe njerëzit që më duan kanë vuajtur pasojat e persekutimit të tepruar, si dhe të shumë gënjeshtrove, por është e vërtetë që në rrugë, çdo ditë e më shumë, e vërteta mbizotëron. Nga këtu u dërgoj

të gjithë punëtorëve, asamblistëve, federatave dhe njerëzve të futbollit në përgjithësi, një përqafim të madh duke u uruar fat të mirë. Faleminderit të gjithëve që më kanë mbështetur në këto çaste”, ka shtuar Rubiales.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 7.1 të Rregullores (ZKA) Nr. 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023), Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, bën këtë:



NJOFTIM
për vazhdim të afatit të konkursit për plotësimin e vendit të lirë të punës të shpallur me datën 24 gusht 2023

Vazhdohet afati për aplikim edhe për pesë (5) ditë, përkatësisht deri me datën **17 shtator 2023**, ora: **16:00** për vendin e punës si më poshtë:

I. Pozita: Specialist për Teknologji të Informacionit- një (1) pozitë;
Numri i referencës: STI/ZKA/10-08/23

Aplikimi i kandidatëve të interesuar bëhet sipas procedurës së përcaktuar në Konkursin e datës 24 gusht 2023.

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
[Signature]

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog çlani 7.1 Uredbe (NKR) br. 03/2021 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjen i dopunjen Uredbom (NKR) br. 01/2023), odeljenje za Upravljanje ljudskim resursima, objavljuje sledeće:

OBAVEŠTENJE
za produženje roka konkursa za popunu upražnjenog radnog mesta objavljenog 24.08.2023

Rok za prijavu se produžava za još pet (5) dana, odnosno do **17.09.2023.godine** u 16:00 časova za sledeće radno mesto:

I. Pozicija: Specijalista informacione tehnologije - jedna (1) pozicija;
Referentni broj: STI/ZKA/10-08/23

Prijava zainteresovanih kandidata vrši se po proceduri definisanoj Konkursom od 24.08.2023.

Odeljenje za Upravljanje ljudskim resursima
[Signature]



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shqipe Zubaku shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Ekonomik – Bachelor drejtimi Menaxhment Informatikë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

